



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 30 Janar 2021

Nr: 20

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 379 DATË 03.01.2021
PËR SHKELJE TË PARASHIKUAR NË VENDIMIN NR. 9, DATË 24.12.2020 TË
KOMISIONIT RREGULLATOR NË KOMISIONIN QENDROR TË
ZGJEDHJEVE NDAJ KRYEMINISTRISË

Në mbështetje të neneve 19, paragrafi 1, shkronja “n”, paragrafi 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

VËREN:

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është raportuar denoncimi nga Instituti i Studimeve Politike (ISP), në ndërfaqen e “Aktiviteteve të Ndaluara”, në rubrikën “Kallëzo”, për përdorimin e materialeve propagandistike në maskën e përdorur nga Kryeministri në aktivitete zyrtare shtetërore.

Sipas denoncimit, më datë 03.01.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID 379, ora 18:51, pretendohet se: “Koncepti i monitorimit të burimeve shtetërore në periudhën 4 muaj përpara zgjedhjeve lidhet me nevojën që shteti/zyrtarët e lartë të mos përdorin funksionin zyrtar dhe paratë / mjetet publike për fushatë. KQZ ka publikuar kërkesat e institucioneve për aktivitete, por të gjitha aktivitetet e Kryeministrit të raportuara në faqen e KQZ midis datës 29, 30, 31 dhjetor 2020 ka pasur shkelje të dispozites ligjore, pasi kryeministri përdor siglën e PS në aktivitete zyrtare



Data: 30 Janar 2021

Nr. 20

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 379 datë 03.01.2021 për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Kryeministrit”

shtetërore, gjë që automatikisht e bën aktivitetin me natyrë partiake. Sigla e PS është përdorur në çdo dalje të kryeministrit në aktivitete me fonde shtetërore, në Tiranë, Vlorë, Shijak dhe Durrës”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi denoncimin, në verifikimin paraprak të të dhënave, konstatoi se:

Referuar nenit 1, të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, *“qëllimi i këtij vendimi është vendosja e rregullave në funksion të marrjes së masave, monitorimit dhe parandalimit të veprimtarive të ndaluara, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të institucioneve qendrore e vendore, si dhe të administratës shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 (katër) muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve, me synim garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike, krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime partiake”*

Neni 3, paragrafi 2, i Vendimit Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator ka përcaktuar rrethin e subjekteve të cilët ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi sipas përcaktimit të mëposhtëm:

“Kryeministri, administrata e tij, Zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësministri, administrata e tyre, kryetari i bashkisë zëvendësit dhe administrata e tij, Prefekti dhe administrata e tij, drejtori i përgjithshëm i agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave ose Ministrët, drejtori i përgjithshëm, drejtorët e departamenteve, drejtorët e drejtorive dhe administratat respektive, drejtuesit dhe anëtarët e organeve kolegjiale, enteve, bordeve, çdo drejtues i shoqërive tregtare në administrim nga shteti si edhe në çdo ent ku shteti zotëron aksione e kapitale/kuota apo emëron shumicën e organit mbikëqyrës ose të organit administrues, titullari dhe zëvendësit e tij për ndërmarrjet shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi denoncimin, në verifikimin paraprak të të dhënave, konstatoi se nuk janë paraqitur mjaftueshëm fakte, argumente juridik, prova dhe rrethana të cilat bëjnë që aktivitetet e realizuara midis datës 29, 30, 31 dhjetor 2020 nga Kryeministri i Shqipërisë, të jenë në kundërshtim me Vendimin nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të konsiderohen aktivitete të ndaluara gjatë periudhës kohore 4 (katër) muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve.



PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të neneve 19, paragrafi 1, shkronja “n”, paragrafi 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60, 61 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Mosfillimin e procedurës administrative, për shkak të mungesës së fakteve dhe rrethanave që përfshihen në fushën e zbatimit, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 09/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Kopje: 2
Afati i ruajtjes: 5 vjet
Punoi:
E. Meta _____
M. Koja _____
Y. Merkaj _____



Data: 30 Janar 2021
Nr: 20

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 379 datë 03.01.2021 për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Kryeministritë”